



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT



Nr. 3029/ prot.
Tiranë, 09. 3. 2026

Nr. 879/ prot.
Tiranë, 12. 03. 2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

DHE

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit/Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, person juridik publik, me adresë: Rruga “Aleksandër Moisiu”, nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, përfaqësuar nga Zëvendësministri znj. Lira Pipa (në vijim referuar DDA),

Dhe

Autoritetit të Mediave Audiovizive, person juridik publik, me adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II”, nr. 15, Tiranë 1010, përfaqësuar nga Kryetari znj. Armela Krasniqi (në vijim AMA).

Parathënie:

- DDA është strukturë pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit dhe ka si detyrë dhe përgjegjësi propozimin, hartimin dhe zbatimin e strategjisë për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të;
- AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimit audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi. Në bazë të rekomandimit të KLSH palët angazhohen të

lidhin marrëveshje dy palëshe DDA-ISHMT dhe DDA-AMA, në kuadër të bashkërendimit sipas rekomandimit të sipërcituar.

- Mosrespektimi i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura nga subjektet përdorues në tërësi dhe operatorët audiovizivë në veçanti që ofrojnë shërbime për publikun, ka sjellë pasoja të dëmshme për sa i përket vlerave reale të veprave letrare, artistike dhe shkencore;
- Nismat e reja ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare synojnë sigurimin e mbrojtjes së të drejtës së autorit veçanërisht në fushën digjitale;

Meqënëse Palët:

- *Konsiderojnë* objektiv të rëndësishëm rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së veprimtarisë tregtare të operatorëve ekonomikë bazuar në respektimin dhe garantimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to;
- *Synojnë* bashkëpunimin me qëllim përmbushjen dhe realizimin e objektivit të kësaj marrëveshjeje;
- *Angazhohen* për të përmbushur detyrimet institucionale që burojnë nga legjislacioni kombëtar për të drejtën e autorit dhe mediat audiovizive.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh angazhimet dhe bashkëpunimin e deritanishëm, Palët lidhin këtë Marrëveshje, sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në:

- a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b) Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar;
- c) Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është:

- a) Bashkëpunimi midis Palëve për bashkërendimin e veprimeve me qëllim garantimin, parandalimin dhe ndalimin e cenimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas parashikimeve akteve ligjore që rregullojnë fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe transmetimeve audiovizive;
- b) Përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit për shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve midis Palëve në kuadër të respektimit të së drejtës së autorit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të kompetencave lëndore të secilës Palë.

Neni 4

Përdorimi i informacionit dhe konfidencialiteti

1. Secila nga Palët e kësaj marrëveshje do të përdorë informacionin e shkëmbyer vetëm në funksion dhe për qëllim të ushtrimit të funksioneve të veta ligjore dhe nënligjore.
2. Veprimet dhe shkëmbimet e informacioneve do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon fushën e veprimtarisë së secilës Palë.
3. Secila prej Palëve ka detyrimin për të ruajtur dhe administruar informacionin që merr nga Pala tjetër sipas akteve në fuqi.
4. Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë pale të tretë informacionin që kanë marrë sipas objektit të kësaj marrëveshjeje, pa marrë më parë miratimin paraprak të palës që jep informacionin.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

1. DDA propozon, harton dhe zbaton strategjinë dhe politikën e duhur për mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të.
2. AMA kontrollon zbatimin e ligjit nr. 97/2013 nga mediat audiovizive dhe shërbimet mbështetëse të tyre, i cili përcakton parimin e garantimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të nga operatorët e shërbimit audioviziv, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit.
3. AMA në rast se, gjatë kontrollit të zbatimit të ligjit për mediat audiovizive, konstaton shkelje të së drejtës së autorit nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv ka të drejtë të vendosë sanksione, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2013.
4. Palët kanë detyrimin e përcjelljes së ankesës pranë organit publik kompetent për shqyrtimin e çështjes, në rastet kur procedura nis me kërkesë të palëve.
5. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e garantimit të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe forcimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në fushën e mediave audiovizive.
6. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për mbrojtjen e të drejtës së autorit në fushën digjitale dhe kundër pirtarësisë, sipas parashikimeve kombëtare dhe detyrimeve ndërkombëtare.

Neni 6

Mënyra e bashkëpunimit

Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara në aktet ligjore në fushën e garantimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit, i cili do të përfshijë:

- a) Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta që i shërbejnë zbatimit të kuadrit ligjor në fushat respektive;

- b) Zhvillimin e takimeve të përbashkëta, kur vlerësohet e nevojshme, mbi vlerësimin e ecurisë dhe problematikave të hasura, si dhe koordinimin e veprimtarisë vijuese, për sa i përket shkeljeve dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit;
- c) Shkëmbimin e informacionit lidhur me ankesat që vijnë nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv, lidhur me agjencitë e administrimit kolektive të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura;
- ç) Shkëmbimin e informacionit të ndërsjellë mbi masat administrative, për shkeljet e të drejtave të autorit, të marra për subjektet vepruese në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim shmangien e sanksionimit disa herë për të njëjtën kundërvajtje administrative, si dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave midis institucioneve si AMA dhe ISHMT;
- d) Angazhimin reciprok për dhënien e kontributit në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushat respektive të mbuluara nga palët, për sa i përket të drejtës së autorit;
- dh) Shkëmbimin e informacionit dhe rekomandimeve për çështjet që lidhen me të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të;
- e) Përcjelljen e informacionit për pjesëmarrjen në veprimtari si trajnime, seminare, konferenca dhe të tjera, sipas fushës së veprimtarisë së institucionit dhe të cilat lidhen me mbrojtjen e të drejtave të autorit.
- f) Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për mbrojtjen e të drejtës së autorit në fushën digjitale dhe kundër pirtarërisë, sipas parashikimeve kombëtare dhe detyrimeve ndërkombëtare.

Neni 7

Ndryshime të mëtejshme

1. Palët bien dakord të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe shtesa në këtë marrëveshje bashkëpunimi, kur vlerësohet e nevojshme.
2. Në varësi të ndryshimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit në internet palët bien dakord të vazhdojnë bashkëpunimin sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore kombëtare dhe atyre të Bashkimit Evropian.
3. Çdo shtesë dhe ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga Palët.

Neni 8

Shkëmbimi i informacionit

1. Palët marrin përsipër të përcjellin informacionin sipas pikës 6, çdo gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.
2. Komunikimi ndërmjet palëve, lidhur me zbatimin e marrëveshjes realizohet në formë shkresore dhe nëpërmjet postës elektronike në adresat zyrtare të institucioneve.

Neni 9

Personat e kontaktit

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, pavarësisht formës.
2. Personat e kontaktit vendosen, me shkresë zyrtare, nga titullari i institucionit.
3. Personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni do të jenë përgjegjës për saktësinë e çdo informacioni dhe dokumenti shoqërues që do të dalë në zbatim të Marrëveshjes. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni, secila palë, njofton përmes shkresës zyrtare brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
2. Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshje do të zgjidhen me bisedime mes Palëve, në kuadër të vullnetit të mirë.

Neni 11

Dispozita te fundit

1. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet për një afat 2 vjeçar.
2. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse.
3. Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta, në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

Për
MINISTRINË E TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT

ZËVENDËSMINISTRI

LIRA PIPA



Për
AUTORITETIN E MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

KRYETAR

ARMELA KRASNIQI

